



REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep.	2-D/DPK
Dep.	Nr. fletë
Dep.	Broj stranica
Nr. paqes	03
Nr. prot.	
Bir. prot.	
Prot No.	
01-1878/14	
Data	
Datum	
Date	
26.05.2014	
PUNSHOTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	23.05.2014
REFERENC-Ë:	AKK-D.P.K.
PËR/ZA/TO:	z. Ardian Behra – Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së,
Cc:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni – Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	<b>Opinion</b> - Ofrimi i këshillimit profesional lidhur me Parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik

### Inderuari ztr. Behra

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK-03-1724/14), ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

Prandaj, bazuar në kërkesen tuaj, se a paraqet konflikt interesit ushtrimi i funksionit publik si Anëtar i Bordit të OSHP-së për zyrtaren e lartë znj. Vjollca Kurtishaj ne raport me angazhimin e bashkëshortit të saj ztr. Muhamet Kurtishaj - si Ekspert Teknik në ekspertiza të OSHP-së, në

Faqe 1 nga 1



pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, për rastin e caktuar, kemi nxjerr këtë :

## OPINION :

Nuk ka konflikt interes i faktik as të vazhdueshëm në ushtrimin e funksionit publik të Anëtarit të Bordit të OSHP-së dhe kandidatit për ekspert teknik në OSHP, por ka konflikt interes i mundshëm që mund të paraqitet rast pas rasti gjatë ushtrimit të funksionit publik. Për tu parandaluar ai, zyrtari i lartë është i obliguar që ta deklaroj ate. Kjo po ashtu lidhet edhe me rregullat e etikës.

Ushtimi i funksioneve publike nënkuption që zyrtarët e lartë nuk duhet që të lejojnë që interesat e tyre private të bien në konflikt me funksionet e tyre. Ata duhet të shmangin konfliktin e interesit pavarsisht nëse ai është real (faktik) apo i mundshëm.

Këtu do tu njoftojmë cilat situata konsiderohen konflikt interes i përzgjigjemi në bazë të kërkesës tuaj me numër protokoli të AKK-së DPKI-03-1724/14, do të përgjigjemi në pyetjen që ju e keni parashtruar në shkresën tuaj të datës 13.05.2014.

Së pari është me rëndësi të citojmë nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përkufizon *çka është konflikti i interesit?*

Nga ky përkufizim kuptojmë, pos të tjerash, se; “*konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtëpërdrejta ose të tèrrthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, ose duket sikur ndikojnë në ligjshmérinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik*”.

Po ashtu në Nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit janë të përcaktuara detyrimet e zyrtarit të lartë për të shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në rastin konkret secili nga zyrtarët për të cilët ju keni pyetur, por jo vetëm ata, duhet që në raste të caktuara të bëjë deklarimin rast për rast të interesave private.

Kjo është e rregulluar me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në tri paragafe të nenit 13, si vijon:

**1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.**

**2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe**



*bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.*

*3. Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

Në Rregulloren e punës së OSHP-së, nen 12 me kater paragafe është i rreguluar edhe Konflikti i interesit si vijon:

(1) Një Ekspert i Shqyrtimit apo një anëtarë i Panelit Shqyrtues, një ekspert apo këshilltarë i pavarur, një anëtarë i ekipit të OSHP-së, nuk do të jetë i përfshirë në shqyrtimin e një rasti, nëse ai / ajo përballet me një konflikt të interesit të vendosur nga dispozitat e Ligjit Nr.03/L-155, i amandamentuar si Ligji Nr.02/L-133, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike (Ligj Nr.04/L-051, / vërejtja e AKK-së)

(2) Duke konsideruar ato që janë përmendur më sipër dhe arsyet për përjashtim, personi në fjalë duhet që menjëherë të njoftojë Kryetarin e OSHP-së, i cili do të merr vendim për përjashtim.

(3) Përjashtimi i Kryetarit të OSHP-së, do të vendoset në Bordin e OSHP-së, udhëhequr dhe kryesuar nga një Anëtarë tjetër në vend të Kryetarit.

(4) Rregulloret e njëjta me ato të përjashtimit të anëtarëve të OSHP-së, aplikohen për përjashtimin e Ekspertëve Shqyrtues. Përjashtimi i tyre do të vendoset nga Bordi i OSHP-së.

Mundësia për të qenë konflikt interesit mes Panelit Shqyrtues dhe Ekspertit teknik është te Paneli 5 anëtarësh, por edhe në këto raste Rregullorja e punës së OSHP-së ka paraparë zgjedhje që është e paraqitur në nenin 23 paragrafi 9 (Përberja e Paneliti Shqyrtues), si vijon:

*“Nëse ndonjë anëtar i Panelit Shqyrtues pesë-anëtarësh nuk ka mundësi të marr pjesë në Panel Shqyrtues , përkatësisht mungon për arsyet e ndryshme siç janë sëmundja, mungesa e arsyeshme nga puna apo konflikti i interesit, Kryetari i OSHP-së , ka të drejtë që ta ndryshoj Panelin Shqyrtues prej pesë anëtarësh në Panelin Shqyrtues në përbërje prej tre anëtarësh”.*

Kjo po ashtu është e rregulluar edhe me vet Kodin etik të prokurimit publik, në Nenin 4, në të cilin parashihet po ashtu deklarata e interesit. Aty shprehimisht thuhet:

#### **4.1 Deklarata e interesit**

*Aty ku mund të ketë ndonjë interes personal, drejtpërdrejt ose tërthorazi, qoftë përmes biznesit, familjes ose miqve, ose përmes lidhjeve tjera, interes i cili mund të ndikojë ose mund të konsiderohet nga të tjerët me arsyet se mund të ndikojë në gjykimin e personit dhe paanshmërinë e tijë, në çfarëdo çështje relevante për detyrat e tij/saj, atëherë ai interes duhet që të deklarohet në mënyrë të qartë para eprorëve para se të ndërmerr ndonjë veprim në procesin e prokurimit.*

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij Opinionit të bazuar në Ligj dhe Rregullore përkatëse, për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë zyrtarët tuaj në gjendje të konflikti të interesit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me respekt,



---

#### Faqe 4 nga 1

---

Adresa: Rruga „Nazim Gafurri“ nr 31-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon/Faks: 038- 518-955  
<http://www.akk-ks.org>,

